

E ENJTE DATA 2 SHKURT 2023

FJALA E DEPUTETIT GAZMENT BARDHI

Zonja Kryetare,

Së pari, siç jeni në dijeni, pikërisht për të shmangur këtë keqinterpretim që ju i bëni Rregullores, përveç kërkesës së kryetarit të grupit, interpelanca me Kryeministrin është kërkuar edhe nga 7 deputetë, duke ju njoftuar që në emër të tyre këtë interpelancë do ta zhvilloj unë. Unë nuk kam kërkuar interpelancë me Elisa Spiropalin, kam kërkuar interpelancë me Kryeministrin. Nuk është kapur Elisa Spiropali në vendimin e drejtësisë amerikane, duke korruptuar një zyrtar të lartë të FBI-së, por është kapur Edi Rama në flagrancë nga drejtësia amerikane, duke korruptuar një zyrtar të lartë të FBI-së. Unë nuk po bëj interpelancë për një çështje apo veprimtari të Këshillit të Ministrave, por për një veprimtari private të Kryeministrit, të kryer në mënyrë private në restorante, në bare dhe në parkingje restorantesh. Dëgjova këtu ministren e Shtetit të pyeste, se pse kemi frikë ta zhvillojmë interpelancën me të, problemi është pse ka frikë Edi Rama të vijë në parlament, problemi është pse për një veprimtari kriminale, të kryer personalisht nga Edi Rama, tenton të keqpërdorë një zonjë, që në rastin konkret është ministre, dhe të fshihet pas fustanit të saj. Ai le të vijë këtu, të japë llogari, të japë shpjegime... (Ndërhyrje nga salla) Jo, po me jelek.

Pra, të japë shpjegime, të sqarojë opinionin publik se ku i ka gjetur 225 mijë dollarët, që ka korruptuar zyrtarin e FBI-së, për të stisur një histori kundër opozitës. Kjo nuk është çështje qeveritare, është aferë personale e Edi Ramës. Kështu, zonja Kryetare, edhe një herë dua ta përsëris: Rregullorja e Kuvendit nuk ka një pikë (ma gjeni ku është), që thotë se Kryeministri që kërkohet për interpelancë, mund ta delegojë interpelancën te dikush tjetër. Nuk e parashikon Rregullorja. Rregullorja thotë shprehimisht: "Interpelanca është kërkesa me shkrim drejtuar Kryeministrit, zëvendëskryeministrit ose çdo anëtar tjetër të Këshillit të Ministrave për të dhënë shpjegime në lidhje me aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së tyre". Unë kërkoj shpjegime për veprimtarinë e Kryeministrit, nuk kërkoj shpjegime për veprimtarinë e ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Prandaj, ju lutem, po e përsëris edhe një herë, bëhuni serioze, ushtroni autoritetin tuaj, si Kryetare e Kuvendit, për të respektuar Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit! Zonja Kryetare, ju jeni aty si garante e Kushtetutës dhe e Rregullores. Ne jemi republikë parlamentare, nuk jemi republikë kryeministore, që e vendos Edi Rama nëse duhet të vijë apo jo, që t'i japë llogari parlamentit. Javën e kaluar nxori që ishte sëmurë, pra e shtyu llogaridhënien me procedurë, me raport mjekësor, a mund ta dimë se çfarë arsye ka sot që nuk është këtu për t'i dhënë llogari parlamentit? Ka marrë përsëri raport?! Është përsëri sëmurë?! Ka përsëri temperaturë?! Unë e di pse fshihet, fshihet sepse e di dhe është i ndërgjegjshëm, që hetimet në SHBA nuk kanë përfunduar ende dhe ai nuk e di se çfarë ka në dosje ose, më saktë, di çfarë ka bërë, por nuk di çfarë...